



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 16 gusht 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Kontaktet me W04290-n

**Ushtruesit të Detyrës së
Zëvendësprokurorit të Specializuar**
Vard Ferdinandse

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21(2) dhe (4)(c), 40(2) dhe 40(6)(f) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 qershor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim ("Vendimi mbi Kontaktet")¹ i cili përcakton Kornizën për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar ("Protokolli").²

2. Më 27 dhjetor 2022, Gjykata e Apelit rrëzoi apelet e ekipeve të Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Kontaktet dhe konfirmoi Protokollin ("Vendimi i Apelit").³

3. Më 21 qershor 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") informoi Trupin Gjykses, palët dhe pjesëmarrësit lidhur me vendimin e saj "për të mos thirrur në këtë fazë W04290-n, dhe për të mbajtur nën shqyrtim domosdoshmërinë e dëshmisë së tij gjatë paraqitjes së provave [prej Prokurorisë]".⁴

4. Më 26 qershor 2023, Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja") i kërkoi sqarime ZPS-së në lidhje me ndikimin e këtij vendimi mbi kontaktet e Mbrojtjes me W04290-n. Mbrojtja sugjeroi se Protokolli nuk duhet të zbatohet në lidhje me

¹ F00854, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar*, 24 qershor 2022.

² Vendimi mbi Kontaktet, para. 212.

³ IA024/F00019, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim në lidhje me Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar*, 27 dhjetor 2022.

⁴ Shih Korrespondencën 271.

W04290-n dhe se Mbrojtja duhet të lejohej të intervistonte W04290-n para dëshmisë së W04746-ës dhe pa praninë e ZPS-së.⁵

5. Më 28 qershor 2023, ZPS-ja iu përgjigj Mbrojtjes duke thënë se radha e thirrjes së dëshmitarëve nuk ka ndikim mbi zbatimin e Protokollit.⁶

6. Më 4 korrik 2023, Mbrojtja dorëzoi një kërkesë lidhur me kontaktimin e W04290-s ("Kërkesa").⁷

7. Më 14 korrik 2023, ZPS-ja u përgjigj ndaj Kërkesës ("Përgjigja").⁸

8. Mbrojtja nuk u kundërpërgjigj.

II. PARASHTRIME

9. Mbrojtja kërkon nga Trupi Gjykses që të sqarojë se Mbrojtja është liruar nga detyrimet që burojnë nga Protokollin për të folur me W04290-n.⁹ Ajo argumenton se deklarata e ZPS-së se nuk kërkon të thërrasë W04290-n për të dëshmuar në këtë fazë: (i) është ndryshim material i rrethanave;¹⁰ dhe (ii) nuk vjen prej shqetësimeve për radhën e paraqitjes së dëshmitarëve apo për efikasitetin, por është vendim strategjik nga ana e ZPS-së, pasi ky dëshmitar mund të paraqesë prova të qenësishme shfajësuese.¹¹ Mbrojtja parashtrohet se kur ZPS-ja identifikon dëshmitarët që nuk synon t'i thërrasë më, vetvetiu ndryshon edhe aftësia e Mbrojtjes për t'i kontaktuar këta dëshmitarë.¹² Mbrojtja parashtrohet se një interpretim i thjeshtë i Protokollit përcakton se ky është i vetmi konkluzion i

⁵ Shih F01639/A02, Mbrojtësi i Specializuar, *Shtojca 2 e Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Kontaktet me W04290-n*, 4 korrik 2023, konfidenciale.

⁶ Shih Shtojcën 2 të Kërkesës.

⁷ F01639, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Kontaktet me W04290-n*, 4 korrik 2023, konfidenciale, me shtojcën 1 dhe 2, konfidenciale.

⁸ F01677, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Thaçit lidhur me Kontaktet me W04290-n*, 14 korrik 2023, konfidenciale.

⁹ Kërkesa, para. 13, 17.

¹⁰ Kërkesa, para. 1.

¹¹ Kërkesa, para. 10.

¹² Kërkesa, para. 10.

arsyeshëm që mund të nxirret prej njoftimit të ZPS-së se nuk do të thërrasë W04290-n për të dëshmuar në këtë fazë.¹³ Mbrojtja parashton se zbatimi i Protokollit duhet kufizuar rreptësisht vetëm tek dëshmitarët që synon të thërrasë ZPS-ja, pasi Protokolli pengon aftësinë e saj që të hetojë dhe të mbledhë prova duke e detyruar Mbrojtjen të zgjedhë midis të drejtës që të hetojë në mënyrë të plotë dhe të drejtës së mosdetyrimit të paraqitjes së provave.¹⁴ Më tej, Mbrojtja argumenton se një intervistim i W04290-s nga Mbrojtja do të ndihmonte në zhvillimin me efikasitet të procesit pasi do të sigurate që Trupit Gjykses t'i paraqiten provat më relevante dhe provuese.¹⁵

10. ZPS-ja përgjigjet se Trupi Gjykses duhet ta rrëzojë Kërkesën.¹⁶ Së pari, ZPS-ja argumenton se nuk ka ndodhur ndryshim material i rrethanave që prej Vendimit të Apelit,¹⁷ kështu që Protokolli vazhdon të zbatohet në lidhje me W04290-n.¹⁸ Së dyti, ZPS-ja parashton se Kërkesa është e parakohshme, pasi Mbrojtja nuk ka kërkuar të kontaktojë W04290-n nëpërmjet Protokollit dhe nuk i ka shteruar në mënyrë të arsyeshme diskutimet mes palëve.¹⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

11. Në Vendimin mbi Kontaktet, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi procedurën e mëposhtme, e cila u konfirmua nga Vendimi i Apelit:²⁰

II. Kontaktet mes një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar

- a. Përveçse sipas kushteve të përcaktuara këtu, palët dhe pjesëmarrësit nuk e kontaktojnë apo intervistojnë dëshmitarin e palës apo pjesëmarrësit tjetër

¹³ Kërkesa, para. 14.

¹⁴ Kërkesa, para. 15.

¹⁵ Kërkesa, para. 16.

¹⁶ Përgjigja, para. 1, 11.

¹⁷ Përgjigja, para. 1, 3-5.

¹⁸ Përgjigja, para. 1, 6.

¹⁹ Përgjigja, para. 2, 7-9.

²⁰ Vendimi i Apelit, para. 106.

para dhënies së dëshmisë, në qoftë se palës apo pjesëmarrësit kundërshtar i është njoftuar synimi për të thirrur dëshmitarin për të dhënë dëshmi, ose për t'u mbështetur në deklaratën e tij.

- b. Në qoftë se dëshiron të intervistojë një dëshmitar të palës apo të pjesëmarrësit tjetër, pala apo pjesëmarrësi kundërshtar informon palën thirrëse, Njësinë e Administrimit të Gjykatës ("NJAGJ") dhe - në lidhje me dëshmitarët me status të dyfishtë - Mbrojtësin e Viktimave, së paku dhjetë ditë para intervistës së synuar. Pala thirrëse përcakton me ndershmëri nëse dëshmitari e jep pëlqimin që të intervistohet nga pala kundërshtare dhe gjithashtu informon dëshmitarin mbi mundësinë e pranisë në intervistë të përfaqësuesit të palës thirrëse, përfaqësuesit ligjor të dëshmitarit, dhe - në lidhje me dëshmitarët me status të dyfishtë - Mbrojtësit të Viktimave, dhe/ose përfaqësuesit të ZMMD-së. Në rrethana të posaçme, një palë ose pjesëmarrës mund t'i kërkojë Trupit Gjykses që në intervistë të jenë të pranishëm edhe përfaqësues të Zyrës Administrative. Pala thirrëse informon palën kundërshtare nëse dëshmitari e jep ose nuk e jep pëlqimin. Gjithashtu, në rast se beson se siguria e dëshmitarit është në rrezik, apo për arsye të tjera legjitime, pala thirrëse mund t'i kërkojë Trupit Gjykses ta lejojë të jetë e pranishme në takimet mes palës kundërshtare dhe dëshmitarit, pavarësisht nga parapëlqimi i shprehur prej dëshmitarit. Në qoftë se pala thirrëse i paraqet Trupit Gjykses një kërkesë të tillë ose e informon palën kundërshtare se do ta bëjë këtë, pala kundërshtare nuk e interviston dëshmitarin derisa Trupi Gjykses të ketë lëshuar vendimin e vet. Procedura e kësaj pjese nuk zbatohet për intervistat e ZPS-së me dëshmitarë të palës kundërshtare në lidhje me çështje të tjera gjyqësore, përveçse kur ZPS-ja planifikon që në ato intervista të bëjë pyetje që janë relevante për akuzat në këtë çështje gjyqësore.
- c. Nëse një palë apo pjesëmarrës kontakton palën kundërshtare apo dëshmitarin pjesëmarrës në mënyrë të paqëllimshme, apo gjatë takimeve të kortezisë të organizuara prej ZMMD-së, pala apo pjesëmarrësi nuk bën asnjë diskutim mbi çështjen dhe nuk kërkon, në asnjë rrethanë, pëlqimin e dëshmitarit për t'u intervistuar drejtpërdrejt. Marrja e pëlqimit të dëshmitarit për t'u intervistuar mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurës së përcaktuar në nënparagrafin e mësipërm.
- d. Pala kundërshtare që kryen intervistën ("pala intervistuese"):
- siguron që intervista të kryhet në mënyrë efektive dhe të shpejtë;
 - përgatit kopje të të gjitha dokumenteve që do t'i tregohen dëshmitarit në një gjuhë që dëshmitari e kupton, së bashku me përkthimin në anglisht që do t'i jepet palës thirrëse;
 - nuk bisedon me dëshmitarin jashtë kuadrit të intervistës dhe të incizimit me video, në mënyrë që të gjitha deklaratat dhe çdo gjë që thuhet të evidentohen si duhet;
 - nuk ndërmerr asnjë veprim që mund të konsiderohet kërcënues apo provokues; dhe

v. respekton urdhrat e lëshuar nga Trupi Gjykses.

[...]

h. [...] Gjithashtu, sipas rastit, Zyra Administrative siguron që gjatë intervistës të jetë i pranishëm një sekretar i gjykatës apo një përfaqësues tjetër i caktuar i Zyrës Administrative, si dhe një përfaqësues për mbështetjen e dëshmitarëve në rastet kur ZMMD-ja e konsideron të nevojshme .

i. Para fillimit të intervistës, pala intervistuese e informon dëshmitarin se :

- i. nuk e ka të detyrueshme pjesëmarrjen në intervistë dhe se mund të vendosë ta ndërpresë intervistën në çdo moment;
- ii. mund të refuzojë t'u përgjigjet pyetjeve, veçanërisht nëse mendohet se mund të jenë vetinkriminuese;
- iii. mund të kërkojë pushim në çdo moment; dhe
- iv. mund të kërkojë takim me një përfaqësues të ZMMD-së në çdo moment gjatë intervistës.²¹

12. Nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe Panelit të Gjykatës së Apelit është bërë e qartë se synimi është që Protokoli të zbatohet vetëm për ata individë të cilët synon të thërrasë si dëshmitarë njëra palë (në këtë rast ZPS-ja) gjatë paraqitjes së provave prej saj.²² Kjo përputhet me pikëpamjen se dëshmitarët nuk janë “pronë” e asnjërës palë,²³ por se për të siguruar integritetin e procesit të paraqitjes së provave duhen marrë disa masa në lidhje me dëshmitarët e palës kundërshtare.²⁴

²¹ Vendimi mbi Kontaktet, para. 212.

²² *Shih p.sh* Vendimin mbi Kontaktet, para. 183-185 (lidhur me përkufizimin e dëshmitarit dhe shprehjen “dëshmitarë të njoftuar”), 212 (Protokolli (II)(a)); F00939, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit F00854*, 26 gusht 2022, para. 94(a) (që miratoi lejen për apel të pikës së tretë të Krasniqit (*d.m.th.* pikën (h)) që i referohej “dëshmitarëve që synojnë të thërrasin palët”); Vendimi i Apelit, para. 43 (“kontaktet mes dëshmitarëve dhe palës jothirrëse”), 77 (shprehja “pala thirrëse” dhe shprehja “dëshmitarët e njoftuar”).

²³ *Shih p.sh.* ICTY, *Prosecutor v Mrkšić et al*, IT-95-13/1-AR73, Appeals Chamber, [Decision on Defence Interlocutory Appeal on Communication with Potential Witnesses of the Other Party](#), 30 July 2003, para. 15.

²⁴ *Shih p.sh.* KSC-BC-2020-07, F00314/A01, Trupi Gjykses II, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 17 shtator 2021, para. 27-40.

IV. DISKUTIM

13. ZPS-ja njoftoi synimin për të thirrur W04290-n dëshmitar në paraqitjen e provave të veta duke e renditur si një prej dëshmitarëve që propozonte në bazë të rregullës 95(4)(b) dhe duke nxjerrë deklaratat dhe transkriptet e intervistës në bazë të rregullës 102(1)(b)(i).²⁵ Ky synim u përsërit kur ZPS-ja e renditi W04290-n fillimisht për të dëshmuar në bllokun e parë të dëshmitarëve të thirrur gjatë paraqitjes së provave.²⁶ Si i tillë, sipas Protokollit, W04290 ishte “dëshmitar i njoftuar”.

14. Trupi Gjykues rikujton se Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit përcakton se:

Në lidhje me procedurën dhe garancitë mbrojtëse për kontaktet me dëshmitarët e palës apo pjesëmarrësit kundërshtar, palët dhe pjesëmarrësit i përmbahen [Vendimit të Apelit]. Nëse një palë ose pjesëmarrës gjykon se **që nga [Vendimi i Apelit] ka pasur ndryshim material të rrethanave që ndikon në bazën mbi të cilën është marrë vendimi, pala apo pjesëmarrësi mund të kërkojë mjetin e duhur juridik nga Trupi Gjykues**.²⁷ (theksimi i shtuar, pa poshtëshënimin)

15. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues do të vlerësojë nëse Mbrojtja ka provuar se ka ndryshim material të rrethanave në lidhje me W04290-n që nga nxjerrja e Vendimit të Apelit, që ka ndikim material në bazën mbi të cilën është marrë vendimi.²⁸

16. Fillimisht, Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja pretendon se “kur ZPS-ja identifikon dëshmitarët që nuk synon t’i thërrasë më, vetvetiu ndryshon edhe

²⁵ Shih F00631/RED/A02/COR/CONF/RED, Prokurori i Specializuar, *Version i Korrigjuar i Shtojcës 2 të Versionit të Redaktuar Publik të Parashtrimit të Dosjes Paraprake, me Listat e Dëshmitarëve dhe të Provave Materiale*, KSC-BC-2020-06/F00631, më 17 dhjetor 2021 (“F00631/A02”), 23 maj 2022, konfidencial, f. 9, nr. 150, f. 257-258. Shih gjithashtu F01594/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit nga Prokuroria të Listës së Përditësuar të Dëshmitarëve dhe Versionit më pak të Redaktuar të Dosjes Paraprake* (“Lista e Përditësuar e Dëshmitarëve”), 9 qershor 2023, konfidenciale, f. 9, nr. 146, f. 249-250. Shih p.sh. Paketën 66 të Materialeve të Nxjerra .

²⁶ F01243/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Prokurorisë të Listës së 12 Dëshmitarëve të Parë dhe Informacionit Shoqërues*, 1 shkurt 2023, konfidenciale, f. 24-25.

²⁷ F01226/A01, Trupi Gjykues, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit* (“Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit”), 25 janar 2023, para. 71.

²⁸ Urdhri mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 71.

aftësia e Mbrojtjes për të kontaktuar këta dëshmitarë.”²⁹ Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se ky përshkrim nuk e reflekton në mënyrë të saktë qëndrimin aktual të ZPS-së në lidhje me W04290-n. Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja ka bërë të ditur se nuk synon të thërrasë W04290-n “në këtë fazë”, pra me bllokun e parë të dëshmitarëve të ZPS-së, porse “ajo ende synon ta thërrasë [W04290-n].”³⁰ Më tej, ZPS-ja ka bërë të ditur se do të mbajë nën shqyrtim domosdoshmërinë e dëshmisë së tij gjatë paraqitjes së provave.³¹ Nga kjo del se ZPS-ja ende synon të thërrasë W04290-n si dëshmitar, por në një fazë të mëvonshme të procesit.

17. Sipas Trupit Gjykses, njoftimi se ZPS-ja nuk synon të thërrasë W04290-n “në këtë fazë” të procesit nuk e ndryshon faktin se ZPS-ja e ka njoftuar Mbrojtjen për *synimin* që të thërrasë dëshmitarin për të dëshmuar.³² Thirrja e dëshmitarit në një radhë tjetër nga ajo e parashikuar fillimisht nga ZPS-ja nuk e ndryshon faktin se Mbrojtja ka qenë dhe mbetet e njoftuar se ZPS-ja synon të thërrasë W04290-n të dëshmojë -- një synim të cilin ZPS-ja e ka përsëritur.³³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk është bindur nga parashtrimi i Mbrojtjes³⁴ se që prej Vendimit të Apelit ka ndryshim material të rrethanave në lidhje me këtë dëshmitar sa të lirojë Mbrojtjen nga detyrimet që përcakton Protokolli për të folur me W04290-n.

18. Së dyti, Trupi Gjykses nuk është bindur as nga parashtrimi i Mbrojtjes³⁵ se, po të mos kishte pasur ndryshim të rrethanave, ZPS-ja nuk do ta kishte njoftuar kurrë Mbrojtjen për ndryshimin e synimit të vet. Trupi Gjykses rikujton se është detyrë e palës paraqitëse që të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur Trupin Gjykses, palët dhe pjesëmarrësit e tjerë për ndryshimet në *radhën* në të cilën

²⁹ Kërkesa, para. 10.

³⁰ Përgjigja, para. 3.

³¹ Shtojca 1 e Kërkesës.

³² *Shih* F00631/A02, f. 9, nr. 150, f. 257-258. *Shih gjithashtu* Listën e Përditësuar të Dëshmitarëve, f. 9, nr. 146, f. 249-250.

³³ Përgjigja, para. 3.

³⁴ Përgjigja, para. 14.

³⁵ Kërkesa, para. 13.

thirren dëshmitarët.³⁶ Nga kjo rrjedh se në këtë rast ZPS-së i kërkohet që t'ia jepte këtë informacion Mbrojtjes. Sikurse është vënë në dukje më lart, një ndryshim i radhës në të cilën thirren dëshmitarët nuk mund të konsiderohet si synim i palës për të mos thirrur një dëshmitar konkret.

19. Së treti, Trupi Gjykses vëren se disa nga argumentet e ngritura nga Mbrojtja në mbështetje të Kërkesës – përkatësisht se zbatimi i Protokollit pengon hetimet e saj dhe aftësinë që të mbledhë prova³⁷ – janë rrëzuar më parë nga Paneli i Gjykatës së Apelit.³⁸ Tashmë, këto argumente janë shqyrtuar në mënyrë të plotë dhe për to është marrë vendim detyrues dhe nuk mund të përbëjnë ndryshim material të rrethanave që nga nxjerrja e Vendimit të Apelit.

20. Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson³⁹ se Mbrojtja është e lirë të kërkojë ta intervistojë W04290-n sipas Protokollit. Duke marrë parasysh se Mbrojtja dëshiron të intervistojë W04290-n “pa praninë e ZPS-së”,⁴⁰ Trupi Gjykses rikujton se, me përjashtim të rrethanave të posaçme, i takon dëshmitarit të vendosë nëse dëshiron që gjatë intervistës të jetë e pranishme pala thirrëse apo kushdo përfaqësues tjetër i identifikuar.⁴¹ Trupi Gjykses rikujton gjithashtu se pëlqimi i dëshmitarit për t'u intervistuar nga pala kundërshtare mund të merret vetëm nëpërmjet procedurës së përcaktuar nga Protokollit.⁴² Në rastin konkret, Mbrojtja duhet të njoftojë së pari ZPS-në mbi dëshirën për të intervistuar W04290-n; nga ana tjetër, ZPS-së do t'i duhet që: (i) të përcaktojë nëse W04290 e jep pëlqimin që të intervistohet nga Mbrojtja; (ii) të informojë W04290-n mbi mundësinë për praninë gjatë intervistës me ZPS-në, të përfaqësuesit ligjor të dëshmitarit, dhe/ose të ZMMD-së dhe të

³⁶ Urdhri mbi Zhvillimin e Gjyimit, para. 80.

³⁷ Kërkesa, para. 15.

³⁸ Vendimi i Apelit, para. 83.

³⁹ Shih F01467, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshim të Vendimit mbi Kontaktet në lidhje me W04147-ën*. (“Vendimi mbi Kërkesën për Ndryshimin e Vendimit mbi Kontaktet”), 17 prill 2023, konfidencial, para. 29. Shih gjithashtu F01250, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Ruajtjen e Provave*, 2 shkurt 2023, para. 40.

⁴⁰ Shih Kërkesën, para. 6. Shih gjithashtu Shtojcën 2 të Kërkesës.

⁴¹ Vendimi mbi Kërkesën për Ndryshimin e Vendimit mbi Kontaktet, para. 26.

⁴² Shih gjithashtu Vendimin mbi Kërkesën për Ndryshimin e Vendimit mbi Kontaktet, para. 27.

përcaktojë nëse W04290 dëshiron praninë e ndonjërit prej tyre; (iii) të informojë Mbrojtjen nëse W04290 e jep pëlqimin për intervistën, dhe se cilin prej përfaqësuesve të identifikuar dëshiron të ketë të pranishëm; dhe (iv) në rrethana të posaçme, pas të jetë konsultuar mjaftueshëmrisht në kohë me Zyrën Administrative, ZPS-ja mund t'i paraqesë Trupit Gjykses edhe një kërkesë për praninë e përfaqësuesve të Zyrës Administrative. Mbrojtja ende nuk e ka nisur procesin e përcaktuar më lart dhe Trupi Gjykses nuk do të paragjykojë asnjë problem në lidhje me respektimin e tij prej palëve.

21. Për sa u përket ndryshimeve të mundshme të listës së dëshmitarëve të ZPS-së muajt e ardhshëm,⁴³ Trupi Gjykses vëren se radha në të cilën thirren dëshmitarët është kryesisht përgjegjësi e palës thirrëse. Kjo radhë nuk ndikon në zbatimin e Protokollit, në qoftë se pala thirrëse synon ende që të thërrasë një individ si dëshmitar në këtë çështje. Trupi Gjykses rithekson se Protokoli zbatohet vetëm për dëshmitarët që synon të thërrasë pala thirrëse (në këtë rast, ZPS-ja). Rrjedhimisht, nëse dhe kur ZPS-ja mendon të mos thërrasë një dëshmitar të listës së vet, ajo duhet t'ia njoftojë në kohë këtë fakt Mbrojtjes. ZPS-së nuk i lejohet që të mbajë individët të varur nga Protokoli nëse nuk synon t'i thërrasë më si dëshmitarë. Kjo e detyron ZPS-në të rishikojë aktivisht dhe vazhdimisht listën e dëshmitarëve të propozuar dhe t'ia njoftojë në kohë Mbrojtjes çdo vendim që merr për të mos thirrur një dëshmitar të caktuar.

22. Rrjedhimisht, në qoftë se vendos që në çfarëdo momenti të mos thërrasë W04290-n (apo cilindo dëshmitar tjetër), ZPS-ja duhet t'ia njoftojë në kohë këtë fakt Trupit Gjykses, Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të Viktimave.

23. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses gjykon se Mbrojtja nuk ka mundur të provojë se rrethanat për dëshmitarin W04290 kanë ndryshuar aq sa të kenë ndikim material në bazën mbi të cilën është marrë Vendimi i Apelit. Rrjedhimisht, Trupi

⁴³ Përgjigja, para. 4.

Gjykues e rrëzon Kërkesën, sqaron se Protokolli vazhdon të zbatohet në lidhje me W04290-n dhe thekson se nëse Mbrojtja dëshiron ta intervistojë këtë dëshmitar, ajo duhet të ndjekë procedurën e përcaktuar në Vendimin mbi Kontaktet.

V. KLASIFIKIMI

24. Trupi Gjykues vëren se edhe Kërkesa (F01639) edhe Përgjigjja (F01677) janë protokolluar si konfidenciale. Trupi Gjykues vëren gjithashtu se ZPS-ja nuk ka kundërshtim ndaj riklasifikimit si publike të Përgjigjes (F01677).⁴⁴ Trupi Gjykues i kërkon Zyrës Administrative të riklasifikojë Përgjigjen si publike dhe urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë versionin e redaktuar publik të Kërkesës, ose të kërkojë riklasifikimin e saj si publike deri **të mërkurën, 23 gusht 2023**.

VI. VENDIM

25. Trupi Gjykues:

- a) **RRËZON** Kërkesën;
- b) **URDHËRON** Zyrën Administrative që të riklasifikojë si publike Përgjigjen (F01677) deri **të mërkurën, 23 gusht 2023**; dhe
- c) **URDHËRON Mbrojtjen** të dorëzojë një version të redaktuar publik të Kërkesës (F01639), ose të kërkojë riklasifikimin e saj si publike deri **të mërkurën, 23 gusht 2023**.

⁴⁴ Përgjigjja, para. 10.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 16 gusht 2023

Në Hagë, Holandë.